



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 1603 Prot.

Tiranë, më 20.06.2023

NJOFTIM
PËR

**HAPJEN E RREGJISTRIMEVE PËR VETËKANDIDIM PËR ANËTAR
TË KOMISIONEVE TË PËRHERSHME TË SENATIT AKADEMIK**

Në zbatim të **nenit 20 dhe 26 të Statutit të UST-së**; të **Vendimit të Senatit Akademik nr. 72 datë 19/06/2023** "Për shfuqizimin e Vendimit nr.68 datë 13.06.2023 "Për hapjen e thirrjes për vetëkandidim për anëtar të Komisionit të Kërkimit, Projekteve dhe Botimeve Shkencore" dhe rihapjen e thirrjes për vetëkandidim në këtë Komision", **Vendimit të Senatit Akademik nr. 73 datë 19/06/2023** "Për shfuqizimin e Vendimit nr.69 datë 13.06.2023 "Për hapjen e thirrjes për vetëkandidim për anëtar të Komisionit të Marrëdhënieve me Studentët" dhe rihapjen e thirrjes për këtë Komision", **Vendimit të Senatit Akademik nr. 74 datë 13/06/2023** "Për shfuqizimin e Vendimit nr.70 datë 13.06.2023 "Për hapjen e thirrjes për vetëkandidim për anëtar të Komisionit të Sigurimit të Cilësisë dhe Kurrikulave" dhe rihapjen e thirrjes për këtë Komision"; të nenit 4 të **Rregullores së Organizimit dhe Funkcionimit të Komisionit të Përhershëm, në Nivel Institucioni, për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë, Botimeve dhe Projekteve Shkencore**; të nenit 4 të **Rregullores për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Përhershëm, në Nivel Institucioni, të Mbarëvajtjes së Veprimtarisë dhe Marrëdhënieve me Studentët**; të nenit 3 (pika 2) të **Rregullores së Organizimit të Veprimtarisë së Komisionit për Kurrikulat**; ftohet personeli i UST-së dhe studentët e Fakulteteve për të paraqitur vetëkandidimin e tyre si anëtarë të Komisioneve të Përhershme:

1- KOMISIONI I KËRKIMIT, PROJEKTEVE DHE BOTIMEVE SHKENCORE

Përbëhet nga 7 (shtatë) anëtarë si vijon:

- 5 (pesë) anëtarë nga personeli akademik i UST që i përkasin kategorisë "Profesor"
- 1 (një) anëtar, i cili vjen nga propozimet e Rektoratit të UST
- 1 (një) anëtar i zgjedhur si përfaqësues i studentëve, (kandidaturat për përfaqësues vijnë të listuara nga Këshilli Studentor).

2- KOMISIONI I SIGURISË SË CILËSISË DHE KURRIKULAVE

Përbëhet nga 5 (pesë) anëtare si vijon:

- 3 (tre) anëtarë nga stafi akademik;
- 1 (një) anëtar i cili vjen nga propozimet e Rektoratit të UST
- 1 (një) anëtar i zgjedhur si përfaqësuesit i studentëve, (kandidaturat për

përfaqësues të vijnë të listuara nga Këshilli Studentor).

3- KOMISIONI I MARRËDHËNIEVE ME STUDENTËT

Përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë si vijon:

- 3 (tre) anëtarë staf akademik
- 1 (një) anëtar i cili vjen nga propozimet e Rektoratit të UST
- 1 (një) anëtar i zgjedhur si përfaqësues i studentëve, (kandidaturat për përfaqësues vijnë të listuara nga Këshilli Studentor).

Kandidatët e interesuar, në momentin e aplikimit duhet të cilësojnë qartë emrin e komisionit ku do të vetëkandidohen, si dhe të jenë të pajisur me nje fotokopje të kartës së identitetit e cila i bashkëlidhet formularit të vetëkandidimit.

Dorëzimi i kërkesës për vetëkandidim në një nga Komisionet e Përheshme, bëhet pranë zyrës së Sekretarit të Senatit Akademik Prof. Asc. Robert ÇITOZI, nga data 20.06.2023 deri me date 26.06.2023 (5 ditë pune) nga ora **08:00 deri në 14:00**.

SEKRETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Asc. ROBERT ÇITOZI

